

KONTRATË PËR BLERJE AKSIONËSH

Në Tiranë, sot më datën 12.04.2005 (dy mijë e pesë), në Dhomën e Noterisë Tiranë para meje Noteres Publike Ermeta Halilaj, ndërmjet:

- a) **Solomon Kapetas**, i biri i Iosif dhe Vedoutsias, biznesmen, lindur në qytetin Trikkala, Trikalon, Greqi, më 25.04.1925, banues në Ekali Attikis, Thalias Str 13, Greqi, mbajtës i pasaportës greke Nr. N768361, (në vazhdim quajtur "Shitësi"), përfaqësuar këtu nga z. Andon Kokoli, mbajtës i pasaportës shqiptare Nr.0865688, në bazë të Prokurës Nr. 10.369/03.03.2005 të redaktuar nga Notere e Athinës znj. Christina Ioanou Stamatopoulou - Stefanou – Ippokratous 10-12, Athinë.
- b) **Shoqërisë anonime "PIRAEUS BANK SA"**, shoqëri e organizuar dhe që vepron sipas ligjeve greke, me seli në Athinë (20 Amalias Avenue & 5, Souri Str.), regjistruar rregullisht në Regjistrin e Shoqërive Aksionere mbajtur nga Ministria e Tregtisë me Nr.6065/06/B/86/04 (në vazhdim quajtur "Blerësi"), përfaqësuar ligjërisht në këtë kontratë nga z. Dimitrios Fraggetis, shtetas grek, mbajtës i pasaportës greke Nr. O 253968, në bazë të Prokurës Nr. 6.392/17.02.2005 redaktuar nga Noteri Publik z. Stefanos K. Vasilakis – Kolokotroni 70, Pire.

Është rënë dakort sa më poshtë vijon:

- 1. Shitësi** ka të drejtën e plotë dhe ekskluzive të pronësisë e posedimit të nëntëqind e nëntëmbëdhjetë (919) aksioneve të regjistruara me një vlerë nominale prej një qind (100) USD secili. Këto aksione përfaqësojnë 0,78% të kapitalit aksioner të shoqërisë anonime "BANKA e TIRANËS", shoqëri që është themeluar dhe që vepron sipas legjislacionit shqiptar, në bazë të Liçensës së Veprimit Nr.07/12.09.1996 lëshuar nga Banka e Shqipërisë. Për këto aksione është lëshuar një certifikatë aksioni provizore (Nr.5, datë 13.10.2004).
- 2. Shitësi** i shet, transferon e dorëzon pronësinë dhe posedimin e plotë të të gjitha aksioneve të sipërpërmendura, dhe më saktë të nëntëqind e nëntëmbëdhjetë (919) aksioneve të regjistruara me një vlerë nominale prej një qind (100) USD secili, që përfaqësojnë 0,78% të kapitalit aksioner të shoqërisë anonime "BANKA e TIRANËS", me të gjitha të drejtat që rrjedhin prej tyre, **Blerësit** i cili e pranon këtë blerje kundrejt çmimit prej njëqind e pesëdhjetë e një mijë e gjashtëqind e tridhjetë e pesë (151.635) EUR. Palët kontraktuese do të procedojnë njëkohësisht në regjistrimin e duhur të këtij transaksioni si në Librin e Aksioneve, ashtu dhe në Librin e Aksionerëve të BANKA e TIRANËS.
- 3. Blerësi** ia ka paguar plotësisht **Shitësit** çmimin prej njëqind e pesëdhjetë e një mijë e gjashtëqind e tridhjetë e pesë (151.635) EUR.

4. **Shitësi** deklaron se aksionet transferohen të lira dhe të pastra nga çdo peng, barrë ose detyrim tjetër ligjor, ose ndonjë difekt aktual ose ligjor në përgjithësi.

5. Palët bien dakort që **Shitësi** nuk ka asnjë të drejtë tjetër ndaj **Blerësit** në lidhje me blerjen e këtyre aksioneve.

6. Pas transferimit të aksioneve, **Shitësi** nuk ka asnjë të drejtë ose titull mbi këto aksione dhe **Blerësi** të cilit i janë transferuar dhe dorëzuar aksionet në kushtet e pronësisë dhe posedimit të plotë, ka të drejtë t'i zotërojë, posedojë, përdorë, shfrytëzojë dhe rregullojë ato sipas vullnetit të tij të lirë si pronar dhe posedues i tyre. **Blerësi** ka të drejtë të ushtrojë të tëra të drejtat që rrjedhin nga e drejta e tij e pronësisë dhe ai do të marrë nga BANKA e TIRANËS çertifikatat përfundimtare të aksioneve kur ato të lëshohen.

7. Çdo mosmarrëveshje që do të lindë në lidhje me ekzekutimin ose interpretimin e kësaj kontrate do të shqyrtohet nga Gjykata kompetente e Tiranës.

8. Palët kontraktuese deklarojnë se heqin dorë nga e drejta për ta apeluar dhe për ta revokuar (shfuqizuar) këtë kontratë.

Në dëshmi të sa më sipër, kjo kontratë ekzekutohet në katër origjinale, nga të cilat nga një kopje u jepet palëve, kopja e tretë mbahet nga Noteri Publik e kopja e katërt depozitohet në Regjistrin Tregtar, dhe konform vullnetit të lirë të palëve, të cilët pasi e lexuan e me zë të lartë në prezencë të përkthyeses Violeta XHAMO lindur më 01.10.1969, lindur e banuese në Tiranë me pasaportë Nr.0063577 dhe mbasi u kuptua nga Palët u nënshkrua rregullisht prej tyre para Noterit.

PALËT KONTRAKTUESE

SHITËSI

Solomon Kapetas

Përfaqësuar me Prokurë nga

Solomon Kapetas

Përkthyesë:

Violeta Xhamo

Violeta Xhamo



BLERËSI

"PIRAEUS BANK SA"

Përfaqësuar me Prokurë nga

D. FRANKETIS
D. FRANKETIS

NOTERI
ERIKETA